

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** - Departamenti për Krime të Rënda,  
me kryetarin e trupit gjykues Skender Çoçaj, me procesmbajtësen Birsen Kume -  
sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit L

K nga Prizreni, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve,  
substancave psiko-trope ose analoge nga neni 275 parag.1 të KP-së sipas aktakuzës së  
PTH në Prizren – PP/I nr.21/2017 të datës 20.04.2017, në seancën e shqyrtimit të  
marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Genc Nixha, të  
akuzuarit dhe mbrojtësit të tij avokat R. K me datë 08.05.2017, mori dhe  
publikisht shpalli këtë:

## AKT GJYKIM

### I akuzuari:

L. K , nga i ati T dhe e ëma Xh e vajzërisë Xh , i lindur  
me datën , në Prizren, beqar, ka të kryer një vjet të shkollës fillore, i gjendjes  
së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Se me datë 06.02.2017 rreth orës 13.45 min. në Prizren, pa autorizim posedon  
narkotikë, substanca psiko trope apo analoge në atë mënyrë që me rastin e bastisjes së  
kryer në shtëpinë e tij familjare e cila gjendet në rrugën “ ” p.nr. në Prizren në  
dhomën e shtëpisë është gjet një kavanoz i mbushur me bari ngjyrë e gjelbër për të cilën  
është konstatuar se kemi të bëjmë me lëndë narkotike e llojit Marihuan e që më pas me  
matje është vërtetuar se i njëjti është në sasi prej 50.7 gram e cila substancë më pas është  
konfiskuar nga ana e policisë.

Këso dore ka kryer veprën penale, posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave  
psikotrope ose analoge nga neni 275 parag.1 të KP-së.


Andaj gjykata në bazë të dispozitivit të lartshënuar 4, 7, 17.1 41, 42, 43, 45,46,  
73 si dhe nenit 275 parag.1 të KP-së , të akuzuarin e:

### GJYKON

-Me dënim me gjobë në lartësi prej 300 (treqind) eurove, të cilën shumë i  
akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij  
aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën dënimi me  
gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do ti  
llogaritet një ditë burgim dhe,

-Me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj.

Në pajtim me dispozitën e nenit 275 paragrafi 3 konfiskohet substanca narkotike e  
llojit marihuanë në peshë prej 50.7 gram.



## Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur aktakuzën PP/I nr.21/2017 të datës 20.04.2017, kundër të akuzuarit L. K., për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psiko-trope ose analoge nga neni 275 parag.1 të KP-së si dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë PP/I nr.21/2017 të datës 20.04.2017.

Gjykata në seancën e shqyrtimit fillestar në pajtim me dispozitat e nenit 247 të KPP-së ka shqyrtuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit gjatë seancës ka ngelur në tërësi pranë marrëveshjes së arritur duke shtuar se ne kemi filluar hetimet ndaj të akuzuarit L. K. për veprën penale blerja, posedim shpërndarje dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, nga neni 273 parag.1, mirëpo gjatë hetimeve e posaçërisht nga deklarata e këtui të akuzuarit L. K. si dhe provat e tjera kemi konstatuar se i njëjti është përdorues i narkotikut -3-4 vite dhe se narkotiku i cili është gjetur në shtëpinë e tij me rastin e bastisjes të kryer nga ana e policisë me dyshim të kryerjes së një tjetër veprë penale është gjetur në kavanoz me substancë narkotike e për të cilën më pas vet i akuzuari ka pranuar se është substancë narkotike e llojit marihuanë dhe se të njëjtën e mbanë për nevojat e veta personale. Ashtu që neve i kemi propozuar të akuzuarit dhe mbrojtësin e tij arritjen e një marrëveshje ku kemi shkuar me ri cilësim të veprës penale dhe të njëjtin e kemi akuzuar për posedim nga neni 275 parag.1 të KP. Konsideroj se në bazë të provave si dhe vullnetit të shprehur nga ana e L. K. kemi arritur marrëveshjen të cilën e kemi para vetes dhe unë propozoj që kjo marrëveshje e përpiluar me shkrim dhe në bazë të vullnetit të lirë edhe të akuzuarit që të aprovohet nga ana e juaj dhe të vendosni në kuadër të sanksionit të cilën kemi paraparë në marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit ka deklaruar se pas informacionit se gjatë bastisjes pjesëtarët e policisë në shtëpinë e të akuzuarit L. K. me ç'rast është gjetur një kavanoz me substancë të dyshuar narkotike është filluar dhe janë mbajtur konsultimet me të akuzuarin me ç'rast është shprehur vullnetarisht se mbrojtësi i tij të bëjë një kërkesë Prokurorisë së shtetit për të hyrë në marrëveshje për pranimin e fajësisë. Një gjë e tillë është bërë prokuroria e shtetit ka caktuar një seancë ku kanë marrë pjesë i akuzuari dhe unë si mbrojtës i tij dhe kemi arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë për të gjitha pikat e aktakuzës të cilat edhe e ngarkojnë të akuzuarin. Marrëveshja është arritur në bazë të vullnetit të lirë, pa presion nga askush dhe si të tillë gjykatës i propozojmë që kjo marrëveshje të aprovohet sipas propozimit të prokurorisë së shtetit.

I akuzuari L. K. është pajtuar me fjalët të dhënë nga mbrojtësi i tij.

Gjykata nën kushtet dhe rrethanat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Sa i përket gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar ashtu si është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës në kushtet dhe rrethanat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë kështu që gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari L. K. se me datë 06.02.2017 rreth orës 13.45 min. në Prizren, pa autorizim posedon narkotikë, substanca psiko trope apo analoge në atë mënyrë që me rastin e bastisjes së kryer në shtëpinë e tij familjare e cila gjendet në rrugën " " p.nr. në Prizren në dhomën e shtëpisë është gjet

Pas dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, si dhe të akuzuarit lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjykata konstatoi se i akuzuari L. K. ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari gjykata ka konstatuar se i akuzuari në asnjë mënyrë nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar ta pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat janë paraqitur në aktakuzë të pranuar edhe nga i akuzuari dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat që parashihen në dispozitat e nenit 253 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së për hudhjen e aktakuzës, prandaj edhe ka vendosur që ta pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Lidhur me dënimin prokurori i shtetit ka qëndruar pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe ka shtuar se dispozitat që gjykata me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ti merr parasysh dispozitat për zbutjen e dënimit duke pasur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

I akuzuari dhe mbrojtësi i tij lidhur me dënimin kanë deklaruar se qëndrojnë pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.


Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata mori pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, se është i mosnës së re, se në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KP dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450, dhe 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
P.nr. 41/2017 me datë 08.08.2017.

Procesmbajtësja  
Birsen Kume



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e prokurorisë dhe i akuzuarit kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit në Gjykatën e Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.